

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni-sekretare juridike, në lëndën penale kundër të akuzuarve: V.H. nga P..., për shkak të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KP-së dhe A.H. nga P..., për shkak të veprës penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KP-së, të akuzuar sipas aktakuzës së prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda PP/L.nr.124/2016 të datës 04.08.2016, pas mbajtjes së seancës publike me dt.24.10.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre avokat Orhan Rekathati dhe avokat Nafije Muqaj që të dy nga Prizreni, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. **V.H.**, nga i ati S. dhe e ëma B. e vajzërisë Th., i lindur me 02.07.1992, në P..., ku edhe tani jeton, në Lagjen D..., rr."M.B.", nr..., ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal
2. **A.H.**, nga i ati I. dhe e ëma M., e vajzërisë M., i lindur me 17.09.1995, në P..., ku edhe tani jeton, në rr."Xh.M.", nr... ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ...

JANË FAJTOR

I. I akuzuari V.H.,

Se me datë 11.05.2016, rreth orës 17:30 minuta, në Lagjen D..., në P..., pa autorizim ka poseduar narkotik të llojit marihuanë në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e policisë të automjetit "Opel Corsa", me targa të regjistrimit ... të cilin e drejtonte i akuzuari V.H., në trupin e të pandehurit V. janë gjetur 16 (gjashtëmbëdhjetë) qese najloni me substancë të dyshuar për narkotik të llojit marihuanë në peshë prej 17.97 gram, këto substanca janë shpallur substanca narkotike me ligj.

Këso dore ka kryer veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KP-së.

II. I akuzuari A.H.,

Se me datë 11.05.2016, rreth orës 17:30 minuta, në Lagjen D..., në P..., pa autorizim ka poseduar narkotik të llojit marihuanë në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e policisë të automjetit "Opel Corsa", me targa të regjistrimit ... të cilin e drejtonte i akuzuari V.H., në trupin e të pandehurit A. janë gjetur 7 (shtatë) qese najloni me substancë të dyshuar për narkotik të llojit marihuanë në peshë prej 6.62 gram, këto substanca janë shpallur substanca narkotike me ligj.

Këso dore ka kryer veprën penale, posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KP-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 4, 6, 7,17, 41, 42, 46, 49 paragr,1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73 dhe neni 275 par.1 të KP-së, të akuzuarve iu shqipton:

Të akuzuarit V.H.,

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 1.200 € (njëmijë e dyqindë euro), në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 11.05.2016 e gjerë me datën 07.06.2016, ndërsa shumën e mbetur i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burgim.

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga flotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Të akuzuarit A.H.,

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 1.100 € (njëmijë e njëqindë euro), në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 11.05.2016 e gjerë me datën 07.06.2016, ndërsa shumën e mbetur i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burgim.

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga flotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Ndaj të akuzuarve gjithashtu shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES

Të akuzuarit V.H. i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan, në sasi prej 17.97 gram si dhe automjeti i markës “Opel Korsaa”, viti i prodhimit 1992 me targa të regjistrimit ...si dhe libreza e qarkullimit CRA... si objekte të kryerjes së veprës penale.

Të akuzuarit A.H. i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan, në sasi prej 6.62 gram- si objekt i kryerjes së veprës penale.

Të akuzuarit V.H. dhe A.H., obligohen që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aqë sa bëhen dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate, Departamentit të Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/I.nr.124/2016 të datës 04.08.2016, kundër të akuzuarve V.H. nga P..., për shkak të veprës penale, posedimi i paaautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KP-së dhe A.H. nga P..., për shkak të veprës penale, posedimi i paaautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KP-së, ndërsa me dt.27.09.2017, kësaj gjykate ja ka paraqitur edhe marrveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr.124/16-I të dt.25.09.2017.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit të marrveshjeve mbi pranimin e fajësisë ka ndëgjuar të akuzuarit, mbrojtësit e tyre dhe prokurorin e shtetit.

Prokurori i Shtetit-Beqë Shala gjatë seancës së shqyrtimit të marrveshjeve mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, është lidhur konformë dispozitave të KPP-së, në prezencën e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, me vullnetin e plotë nga ana e tyre dhe nga ana e Prokurorisë Themelore në Prizren, të akuzuarit kanë pas kohë të mjaftueshme që të konsultohen me mbrojtësit e tyre të caktuar sipas detyrës zyrtare nga Oda e avokatëve në Prishtinë.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.H. av.Orhan Rekathati gjatë seancës ka deklaruar se qëndrojnë pranë marrveshjes për pranimin e fajësisë të negociuar dhe nënshkruar në Prokurorinë e Shtetit, meqenëse me të akuzuarin V.H. jemi marr vesh dhe kemi biseduar rreth pikpamjeve për lidhjen e marrveshjes mbi pranimin e fajësisë, se i mbrojturi im është përnduar për kryerjen e kësaj veprë penale dhe që nga ajo kohë nuk është marrë me përdorimin e narkotikut duke premtuar se do të përmirsohet në çdo aspekt.

I akuzuari V.H. gjatë seancës ka deklaruar se pajtohet me fjalët e mbrojtësit të tij av.Orhan Rekathati lidhur me marrveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.H.-av.Nafije Muqaj gjatë seancës ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrveshjes për pranimin e fajësisë të negociuar dhe nënshkruar në Prokurorinë e Shtetit me dt. 25.09.2017, pasi që paraprakisht është konsultuar me të mbrojturin e saj A. H., i cili ka kuptuar të drejtat dhe detyrimet e tij lidhur me veprën për të cilën është akuzuar dhe se i njëjti me pëlqimin dhe vullnetin e lirë ka pranuar që të hyjë në marrveshje me prokurorin e shtetit, të cilën edhe e kemi arritur.

I akuzuari A.H. gjatë seancës ka deklaruar se pajtohet me fjalët e mbrojtëses së tij av.Nafije Muqaj lidhur me marrveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata pas dëgjimit të pikpamjeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrveshjeve mbi pranimin e fajësisë konstatoi se të akuzuarit V.H. dhe A. H. kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, të akuzuarit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga të akuzuarve dhe se nuk ekzistonë asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par.1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës rreth dënimit Prokurori i Shtetit Beqë Shala ka deklaruar se sa i përket dënimit të propozuar në marrveshjet mbi pranimin e fajësisë konsideroj se dënimet e propozuara

janë adekuate dhe proporcionale për veprat e kryera nga ana e të akuzuarve, se dënimet e tilla do të ndikojnë tek të njëjtit që në të ardhmen të mos kryejnë apo përsërisin vepra penale duke konsideruar se dënimet e tilla do të ndikojnë në risocializimin e të akuzuarve.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.H.-av.Orhan Rekathati rreth dënimit i cili është propozuar në marrveshjen mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se, mbetet pranë dënimit për të cilin kanë arritur marrveshje me prokurorinë e shtetit.

I akuzuari V.H. rreth dënimit ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalët e mbrojtësit të tij sa i përket dënimit të rekomanduar.

Mbrojtësja e të akuzuarit A.H.-av.Nafije Muqaj rreth dënimit i cili është propozuar në marrveshjen mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se, mbetet pranë dënimit të rekomanduar nga prokuroria e shtetit, pasi që për të njëjtin janë sqaruar mjaftë mirë nga ana e prokurorit dhe janë pajtuar në tërësi me një dënim të tillë.

I akuzuari A.H.rreth dënimit ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalët e mbrojtëses të tij.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve V. H. dhe A.H., formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka ndërgjuar deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimin e propozuar sipas marrveshjes mbi pranimin e fajësisë duke marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të dy të akuzuarve sipas marrveshjes mbi pranimin e fajësisë, pendimin e tyre dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale, si dhe qëndrim korrekt para gjykatës. Si rrethana rënduese, gjykata mori, se kryerja e veprimeve të tilla inkriminuese në territorin e kësaj gjykate është në rritje e sipër, sikurse edhe rritja e numrit të përdoruesve të substancave narkotike e poashtu edhe pasojat e saj janë të dukshme ndaj shëndetit të popullatës e veçanërisht rinisë e cila lehtë po i nënshtrohet konsumimit të saj. Kështu që kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tyre dhe kto dënime të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe sipas bindjes së gjykatës dënimet e tilla do të ndikojnë mjaftueshëm tek të akuzuarit dhe në rrethinën ku ata jetojnë që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla inkriminuese.

Vendimi mbi konfiskimin u muar konform nenit 275 par.3 të KP-së lidhur me nenin 69 të KP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1666/2016, me datë 24.10.2017

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vendimit mbi dënimin dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.